

**OS**OPERATORI  
I SISTEMIT TE  
TRANSMETIMITREPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE  
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

NR. 8262 PROT. DT. 06.12.2019

Nr. 21469/1 prot.Tiranë, më 6.12 2019**VENDIM I ASAMBLESË SË AKSIONARIT**Nr. 119, datë 6.12.2019**PËR  
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË  
“OST” SHA TIRANË.**

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, me cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë “OST” sha Tiranë, pasi shqyrtova praktikën e dërguar nga shoqëria me shkresën nr. 7589, datë 14.11.2019;

**VENDOSA**

1. Në statutin e shoqërisë “OST” sha Tiranë, në nenin 5 “Objekti” shtohet pika 5.1.4 si me poshtë:

Zhvillimi dhe funksionimi i shërbimeve të komunikimeve elektronike me shumicë të parashikuara në legjislacionin në fuqi për shërbimet e komunikimeve elektronike në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe në përputhje me përcaktimet e autorizimeve që jepen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ku përfshihen :

- Shërbim për ofrimin e transmetimit të të dhënave, të disponueshme për publikun.
2. Bazuar në ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, ngarkohet Administratori i Shoqërisë “OST” sha Tiranë, për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

